



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**  
**DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL**  
SEKTORI I KOORDINIMIT, STUDIMEVE DHE INTEGRIMIT

Nr. 253 / prot.  
16

Tiranë, më 21.03.2024

**Lënda:** Kthim përgjigje.

**KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.475 Prot., datë 19.02.2024, me të cilën kërkonti informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, sa i përket zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, si dhe për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, ju përcjellim informacionin si më poshtë:

- Nga verifikimet në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe të dhënat e Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton se në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm aktualisht janë nën hetim për vepra penale në fushën e zgjedhjeve 5 persona.
- Nga 21 procedime penale që ndiqen nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për 7 prej tyre është kërkuar në gjykatë pushimi i hetimeve, prej tyre 3 kërkesa për pushimin e hetimeve, janë pranuar nga gjykata dhe për 4 kërkesat e tjera për pushim të hetimeve vazhdon shqyrtimi në gjykatë.  
14 procedime penale janë akoma në fazën e hetimeve paraprake.
- Kohëzgjatja e hetimeve të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale në fushën e zgjedhjeve, të cilat kanë përfunduar, varion nga 3 deri 6 muaj. Kurse procedimet penale në proces hetimi kanë kohëzgjatje mbi 9 muaj.
- Nuk rezulton të ketë përfunduar me kërkesë për gjykim asnjë procedim penal.
- Në lidhje me gjininë e personave nën hetim rezultojnë 2 femra, banuese në Konispol dhe 5 meshkuj, banues në Cërrik, me gjendje gjyqësore të pa dënuar, të grupmohave 28 deri në 43 vjeç.

Lidhur me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, zhvilluar me datë 24.09.2023, nuk është regjistruar asnjë kallzim/procedim penal për kryerje të veprave penale në fushën e zgjedhjeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI**  
**KOSTAQ BELURI**

